



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 22 Prot

Peshkopi, më 03.01.2024

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.134

**Datë:** 29.12.2023

**“Për miratimin e Planit Social 2024-2027 të Bashkisë Dibër”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Ilir Elezi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.14/1 prot.

Peshkopi, më 05.01.2024

**Lënda :** Për vendimin nr.134, datë 29.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

**BASHKISË DIBËR**

**DIBËR**

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.134, datë 29.12.2023 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 të Bashkisë Dibër", konstatova:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

**PREFEKTI**  
Nexhibedin SHEHU





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM**

**Nr. 134 Datë 29 / 12 /2023**

**“Për miratimin e Planit Social 2024-2027 të Bashkisë Dibër”**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 24, në ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenet 36,45 ,VKM nr.111 datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, VKM nr.150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social shoqëror”, Sektori i Kujdesit Social në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore, shoqërisë civile si dhe mbështetjen teknike me ekspert të Programit “Leave No One Behind”, të kombeve të Bashkuara përgatiti Planin Social 2024-2027 të Bashkisë Dibër, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 29.12.2023, me 23 pro, 1 kundër dhe 0 apstenim:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit Social 2024-2027 të Bashkisë Dibër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Kujdesit Social, Bashkia Dibër.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **29.12.2023**.

**Kryetare e Këshillit Bashkiak**

**Irimi Shehu**

